

# MODELE PYETJESH NGA MËSUESIT PËR MËSUESIT

ARSIMI I MESËM I ULËT DHE ARSIMI I MESËM I LARTË

LËNDËT:

GJUHË SHQIPE

DHE LETËRSI

TETOR  
2021

**Materiali “Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit”, për lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Letërsi”,** u hartua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me mësues të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë.

**Koordinoi punën për hartimin e materialit**

*Erida Koleci, ASCAP*

**Koordinoi redaktimin shkencor**

*Dr. Gerti Janaqi, ASCAP*

*Dr. Dorina Rapti, ASCAP*

**Koordinoi redaktimin letrar**

*Rozeta Hyseni, ASCAP*

**Koordinoi faqosjen**

*Esion Zgjana*

*Prodhim i ASCAP-it, 2021*

[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)

© Copyright 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP, Tiranë, Shqipëri

# TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	3
HYRJE .....	4
GJUHË SHQIPE.....	5
KLASA VI.....	5
Ndryshimet klimatike .....	5
KLASA VII.....	12
Si të pasuroni fjalorin? .....	12
KLASA VIII .....	19
“Gjenerali i ushtrisë së vdekur” Ismail Kadare.....	19
KLASA IX.....	26
“Konica dhe qëllimi i jetës së tij” F. S. Noli.....	26
GJUHË SHQIPE.....	32
KLASA X .....	32
KLASA XI.....	37
KLASA XII.....	42
LETËRSI.....	47
KLASA X .....	47
KLASA XI.....	52
KLASA XII.....	57

## HYRJJE

Pyetja është mjete më i fortë në dispozicion të mësuesve që t'i mësojnë nxënësit si të mendojnë. Ata bëjnë qindra pyetje çdo ditë, të cilat shërbejnë për të monitoruar vëmendjen e nxënësve, për të hapur biseda dhe diskutime, për të promovuar ndërveprimin nxënës-nxënës, për t'i angazhuar nxënësit në detyra individuale dhe punë në grup, për të përpunuar informacionin, për të inkurajuar të menduarit e pavarur dhe kritik, për ta lidhur dhe zbatuar informacionin me/në situata të jetës reale etj.

Kurrikula që zhvillon kompetencat, kërkon nga mësuesi që pyetjet të mos përqendrohen vetëm në riprodhimin e njohurive lëndore, por edhe në zhvillimin e aftësive, vlerave dhe qëndrimeve. Shumëllojshmëria e pyetjeve dhe nivelet e tyre zhvillojnë kompetencat lëndore, të cilat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënit.

Modelet e pyetjeve nga mësuesit për mësuesit bazohen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për AMU-në dhe AML-në dhe janë pyetje, të cilat mund të përdoren në teste të ndryshme. Këto modele janë hartuar nga vetë mësuesit dhe janë përpjekje e tyre për të zbatuar parimet e kurrikulës me kompetenca. ASCAP ka përzgjedhur disa modele, të cilat mund t'u vijjnë në ndihmë mësuesve të tjerë. Në këtë material ndihmës për mësuesit, për çdo pyetje janë dhënë kompetenca që zhvillon, rezultati i të nxënit, lloji i pyetjes dhe pikëzimi.

# GJUHË SHQIPE

## KLASA VI

### Ndryshimet klimatike <sup>1</sup>

Shumë shkencëtarë e kanë studiuar klimën në të gjithë botën. Ata janë shprehur se klima ka ndryshuar. Për këtë arsye, vende të ndryshme të botës organizuan një konferencë të madhe në Kyoto në Japoni. Çështja kryesore e kësaj konference ishte se çfarë duhet bërë për ndryshimin e klimës. U bënë shumë premtime nga vendet pjesëmarrëse, por pjesa më e madhe e tyre nuk u mbajtën.

Që atëherë, dëshmitë e ndryshimeve klimatike sa vijnë e bëhen më të forta dhe më dramatike. Pajisjet kompjuterike që përdorin shkencëtarët ofrojnë të dhëna shumë të sakta. Shtresat e akullit në Arktik dhe në Antarktidë po shkrihen, madje në disa raste shumë shpejt. Nivelet e



deteve dhe të liqeneve janë ngritur. Temperaturat janë rritur, veçanërisht në Arktik dhe në Antarktidë. Akullnajat e maleve në vende të ndryshme të botës janë duke u shkrirë, veçanërisht në Himalaje. Kafshët dhe bimët, të cilat pëlqejnë kushtet e ngrohta po lëvizin drejt veriut dhe jugut.

Bota po nxehet. Dhe më vjen keq që ta them, por faji është i ne të gjithëve.

### Pyetja 1:

Qëllimi kryesor i autorit të tekstit është që të nxisë te lexuesi:

- A) faj.
- B) frikë.
- C) hakmarrje.
- D) trishtim.

<sup>1</sup> Teksti është marrë nga interneti.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi identifikon qëllimin e autorit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

### **Pyetja 2:**

Përshkruani dy reagime ose veprime që duhet të bëjë njerëzimi për të ndaluar ndryshimet klimatike.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë dhe përvojën e tij.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### **Pyetja 3:**

Në tekst jepen shkaqet apo pasojat e ndryshimeve klimatike? Shkruani dy pasoja të ndryshimeve klimatike.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon shkaqet dhe pasojat në tekst.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

#### **Pyetja 4:**

Shtoni në vendet bosh një përcaktor me përshtatje dhe një përcaktor me drejtim.

Pajisjet \_\_\_\_\_ kompjuterike që përdorin shkencëtarët \_\_\_\_\_ ofrojnë të dhëna shumë të sakta.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përdor në fjali llojet e përcaktorëve.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me plotësim

**Pikëzimi:** 2 pikë

#### **Pyetja 5:**

Pse autori ka zgjedhur ta shoqërojë tekstin me foton e një ariu polar mbi një copë akulli që është duke shkrirë? Çfarë duket se është duke thënë ariu?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon elemente të formës dhe të përmbajtjes së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

## “Dashuria e nënës” Ramadan Pasmaçiu

Dimri hyri me kohë e ne nuk qemë të veshur mirë. Mërdhinim shumë kur shkonim në mëngjes në shkollë. Ishin kohëra të vështira, vitet e para pas luftës. As që dinim ç’ qenë xhupat e palltoja e madhe. Edhe më pisk e kishim kur binin shira. Na bëheshin këmbët ujë e baltë.

Më kujtohet si tani. E kisha nënën të sëmurë. Nuk di nga ç’ sëmundje, veç shihja se si herë zbehej e herë skuqej prush nga temperatura. Babai i rrinte te koka dhe dilte, sillte prapë mjekun.

Një ditë, aty në të ngrysur, vura re se buzët e nënës ishin bërë eshkë. Ajo, e shtrirë në shtrat me sytë pothuajse mbyllur, rënkonte me zë të ulët. U tremba e u drodha. Nuk isha as njëmbëdhjetë vjeç. Kujtova se po vdiste! Pashë në sy babanë dhe psherëtiva thellë, gati në të qarë. Ai më vuri dorën në sup e më tha:

– Ti u rrite! Ç’ janë këto?! A vete të blesh një kile portokaj, t’ia shtrydhim nënës? Mora lekët dhe u sula tatëpjetë shkallëve. Pas aq kohe me qiell të vranët, ia nisi një goxha shi. Vrapova përmes shiut, pa ndaluar askund. Doja të bëja edhe unë diçka për nënën, diçka sado të vogël.

Kur u ktheva, kulloja ujë i tëri dhe mezi merrja frymë. Për çudi nuk ndieja të ftohtë. Një zjarr i brendshëm më ndizte gjithë trupin. Hoqa këpucët dhe i lashë pas derës. Hoqa edhe çorapet e lagura. Gishtat e këmbëve më ishin zbardhur dhe fishkur, po punë e madhe.

I dhashë portokajtë babait dhe prita të më thoshte ndonjë fjalë të mirë se kisha shkuar dhe kisha ardhur shpejt. Pazarin e kishim larg dhe rruga në të kthyer qe plot të përpjeta, po atij as që i vajti ndër mend të më lëvdonte. U ngrym me të më parë dhe më shtyu lehtë drejt oxhakut që të thahesha te zjarri, duke më fshehur me shpatulla prej syrit të nënës që ajo të mos më shihte në atë gjendje e të mos shqetësohej për mua. Por nëna sikur i shpoi me sy shpatullat e babait... Dhe ndodhi e papritura!

– Obobo, djali! – thirri dhe, hop, kërcëu në dysHEME prej shtratit.

Në këtë moment mund të thoje se nuk ishte e sëmura e venitur me buzët e thara. U derdh tek unë me rrëmbim. Më fshiu me peshqir dhe më ndërroi me ç’ mundi. Pastaj u ul pranë zjarrit e më mori në prehër. Filloi të ngrohete nëpër gjuhëzat e flakës duart që i digjeshin dhe fërkonte me to këmbët e mia akull.



Im atë e shikonte nënën i habitur, por s'guxonte t'i fliste. Të dukej se trembej se mos e përmendte. Sikur ajo që ngritur përgjumshëm e sapo t'ia ndiente zërin babait, do të zgjohej, do të kthehej në gjendjen e parë e do të shtrihej tek ishte, pa pikë fuqie. Ndërsa nëna, tek më mbante shtrënguar në gji, si të isha krejt i mitur, tundej me faqen puqur pas kokës sime dhe më mërmëriste aq e aq fjalë të ëmbla...

Të nesërmen u çova vonë. Kur hapja sytë, ndodhi çudia më e madhe. Pranë jastëkut pashë një palë këpucë të tjera, të bukura e të reja fringo, ngjyrë kafe. As që kisha parë e jo më mbathur këpucë të atilla.

Për një çast kujtova se qeshë në ëndërr. Por jo! Nëna po më buzëqeshte nga shtrati i vet. Ishte e këputur dhe rrathët mavi rrotull syve i shquheshin qartë.

– Janë të tuat! – më tha. – T'i mbash me shëndet!

E kishte mposhtur sëmundjen ndonëse për pak kohë. Kishte dalë nga shtëpia herët dhe m'i kishte blerë te ndonjë tregtar! Shtrenjtë, patjetër! Me të hollat që kurseheshin për barnat e saj! Dhe qenkësh kthyer në shtrat! Por tani ishte e qetë e jo si më parë!

Pas disa ditësh u ngrit dhe nisi prapë të sillej nëpër shtëpi si flutur, duke bërë punët. Babai i tregoi gjithçka mjekut. Ai u mendua pak dhe tha:

– Po, njihet ky rast. Dashuria e nënës për fëmijën bën çudira.

### **Pyetja 6:**

Nënën e shëroi:

- A) dashuria për djalin.
- B) ilaçet që përdori.
- C) kujdesi i babait.
- D) mjeku i familjes.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa.

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Pyetja 7:**

Shkruani dy tipare të djalit duke u mbështetur në mendimet e tij dhe në veprimet e tij.

Ilustrojini përgjigjet tuaja me detaje nga teksti.

Mendimet dhe veprimet e djalit	Tipari	Detaji në tekst
	Tipari	Detaji në tekst

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon personazhet duke u mbështetur në veprimet dhe mendimet e tyre.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 4 pikë

**Pyetja 8:**

A ju pëlqen mbyllja e këtij tregimi? Pse?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e hapur

**Pikëzimi:** 2 pikë

### **Pyetja 9:**

Kush i rrëfen ngjarjet në tregim? Në cilën vetë shkruan ai?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon elemente të formës dhe përmbajtjes së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### **Pyetja 10:**

Gjeni figurën letrare në fjalinë “*Pas disa ditësh u ngrit dhe nisi prapë të sillej nëpër shtëpi si flutur, duke bërë punët*”. Pse është përdorur ajo?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon krahasimin dhe tregon funksionin e tij.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

## KLASA VII

### Si të pasuroni fjalorin?<sup>2</sup>

A ju kanë thënë ndonjëherë se sa e rëndësishme është të kesh një fjalor të pasur? Ndoshta jua ka kujtuar gjyshja teksa përpiqeshit të zgjidhnit një fjalëkryq. Ndoshta e keni ndeshur në orën e gjuhës apo kur bëni detyrat e shtëpisë. Megjithëse mund t’ju tingëllojë pak e çuditshme, dijeni se pasurimi i fjalorit është një ide e mrekullueshme. Një fjalor i pasur ju ndihmon shumë në familje e në shkollë që të shprehni mendimet qartë dhe saktë, madje të lini përshtypje të mirë te të tjerët.

A ju ka mësuar ndokush “marifete” se si ta pasuroni fjalorin? Po, ka disa këshilla.

Së pari, nuk është aspak e vështirë të mësosh fjalë të reja dhe të dish kuptimet e tyre. Për këtë, ju mund të shkoni në bibliotekë dhe të kërkoni e të lexoni libra që do t’ju ndihmojnë të zbuloni fjalë të panjohura.

Së dyti, mënyra më e mirë për ta bërë këtë është të mbani shënime për fjalët që nuk i keni hasur më parë dhe nuk ua dinit kuptimin. Ju do të habiteni se sa i varfër ka qenë fjalori juaj.

Mos nguroni të provoni fjalorin tuaj në një ese. Vetë pasurimi i fjalorit ju ndihmon të përmirësoni më tej të folurit dhe punët që shkruani në shkollë. Mësuesit vlerësojnë nxënësit që zotërojnë një fjalor të pasur, dinë të shprehen bukur dhe dinë të bëjnë për vete me një frazë të gjallë e të larmishme. Ju vetë do të shihni se është e lehtë të shkruash një ese, kur ke në mendje një larmi fjalësh, nga të cilat do të zgjedhësh më të përshtatshmet dhe më kuptimplotat.



Kaloni në forma të tjera shkrimi, si tregimi apo në format e ndryshme të të shprehurit me

gojë. Ato përsosin të folurit tuaj. Mos harroni të zgjidhni gjithmonë fjalët e duhura! Kështu, nëse shkruani një tregim, nga mënyra se si do të përzgjidhni fjalët, do të krijoni përfytyrime të ndryshme te lexuesi. Pra, kur ju shkruani: “Djali u ul në divan me kokën mes duarve”, lexuesi

<sup>2</sup> Teksti është marrë nga interneti.

përfytyron një djalë, i cili ulet në divan i shqetësuar, por nëse shkruani: “Djali u lëshua në divan me kokën mes duarve”, atëherë jepet një kuptim krejt tjetër nga i pari. Sa më shumë fjalë të përzgjedhura të përdorni, aq më bukur do të shfaqni gjithçka që ndieni për një ngjarje a person të caktuar.

Kur zotërojmë një fjalor të pasur e të larmishëm, lëmë një përshtypje të mirë të tjerët. Punëdhënësi juaj i ardhshëm do të përzgjidhte atë punëkërkuar që do të zotëronte një gjuhë të pasur e të rrjedhshme. Sot çmohen shumë ata që flasin qartë dhe saktë.

### **Pyetja 1:**

Qëllimi kryesor i autorit është:

- A) të informojë fëmijët për rëndësinë e një fjalori të pasur.
- B) të udhëzojë fëmijët se si të pasurojnë fjalorin.
- C) të tregojë çfarë ndodh me fëmijët kur nuk kanë fjalor të pasur.
- D) të argumentojë pse duhet pasuruar fjalori.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënies:** Nxënësi identifikon qëllimin e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

### **Pyetja 2:**

Këshilla e parë e autorit të tekstit për pasurimin e fjalorit është:

- A) leximi i librave.
- B) mbajtja e shënimeve.
- C) shkrimi i eseve.
- D) të folurit në situata të ndryshme.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Pyetja 3:**

Në cilin paragraf shprehet ideja që një fjalor i pasur është i rëndësishëm jo vetëm në shkollë, por edhe në jetë? Shprehni edhe ju mendimin tuaj në lidhje me këtë ide.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit.

Nxënësi gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e hapur

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Pyetja 4:**

Nënvizoni kundrinorët në fjalinë: “Vetë pasurimi i fjalorit ju ndihmon të përmirësoni më tej punët që shkruani në shkollë.” dhe përcaktoni llojin e tyre.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon kundrinorin dhe përcakton llojin e tij.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 4 pikë

## Pyetja 5:

Cili është kuptimi i fjalës *marifete*? Me ç' fjalë të gjuhës shqipe mund ta zëvendësoni?

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi përcakton kuptimin e fjalës.

Nxënësi gjen sinonime për një fjalë të dhënë.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### “Katedralja e Parisit” Viktor Hygo

#### *Fragment*

Esmeralda u ul hijshëm në shtrat së bashku me dhinë, të cilën e zuri gjumi te këmbët e saj. Që të dy ndenjën një copë herë pa lëvizur dhe në heshtje: ai duke soditur bukurinë e saj dhe ajo duke u habitur me shëmtimin e tij. Vajza po zbulonte te Kuazimodoja për çdo çast ndonjë shëmtim të ri. Vështrimi i saj hidhej prej atyre gjunjëve të shtrembër te shpina gungaçe, prej shpinës gungaçe te syri i vetëm. Nuk po arrinte dot të kuptonte se si mund të kishte në botë një krijesë kaq të shëmtuar. Por këtë shëmtim e mbulonte një melankoli dhe një butësi aq e madhe, saqë pak nga pak filloi të mësohej me të.

Gungaçi theu heshtjen i pari:

- Më thatë të kthehesha?
- Po, - iu përgjigj ajo, duke pohuar me kokë.

Ai e kuptoi drejt mohimin.

- Medet! – vazhdoi të belbëzonte si me ngurrim.- Unë jam ... shurdh.
- I shkreti! –thirri vajza me një shprehje plot dashamirësi dhe dhimbsuri.

Ai buzëqeshi me hidhërim.

- Si ju duket: vetëm kjo më mungonte apo jo? Po unë jam shurdh. Ja që i këtillë jam. Është e tmerrshme apo jo? Kurse ju jeni kaq e bukur!

Në zërin e atij fatziu ndihej një brengë aq e thellë, saqë ciganes nuk i bëri zemra të thoshte asnjë fjalë. Pale pastaj që Kuazimodoja as që do ta kishte dëgjuar:

- Kurrë se kisha ndjerë shëmtimin tim kaq fort sa tani. Kur e krahasoj veten me ju, më vjen keq për veten time, për një përbindësh të mjerë siç jam unë. Pa më thoni, mos jam si ndonjë egërsirë pylli? Ju jeni një rreze dielli, një cirkë vese, një këngë bilbili, kurse unë të kall datën me pamjen që kam, as njeri dhe as kafshë. Jam i vrazhdë, jam më i shëmtuar dhe më i përçmuar se një copë gur.

#### **Pyetja 6:**

Përshkrimi që Kuazimodo i bën vetes para Esmeraldës karakterizohet nga:

- A) arroganca.
- B) hipokrizia.
- C) naiviteti.
- D) sinqeriteti.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon tiparet e personazheve në një tekst letrar.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë



### Pyetja 7:

Si ndryshon qëndrimi i Esmeraldës kundrejt shëmtimit të Kuazimodos në fragment? Ç'pjesë të karakterit të Esmeraldës tregon kjo gjë?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit.

Nxënësi analizon tiparet e personazheve në një tekst letrar.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### Pyetja 8:

Gjeni një figurë letrare në fjalinë: *“Vështrimi i saj hidhej prej atyre gjunjëve të shtrembër të shpina gungaçe, prej shpinës gungaçe te syri i vetëm.”*. Cili është funksioni stilistik i saj?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare


**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi dallon figurat letrare dhe përcakton funksionin e tyre.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### Pyetja 9:

Evidentoni nëpërmjet një Diagrami të Venit të përbashkëtat dhe dallimet mes Kuazimodos dhe Esmeraldës.



**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon të përbashkëtat dhe të veçantat mes personazheve.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 4 pikë

**Pyetja 10:**

Ç' ndjesi provoni për Kuazimodon kur lexoni fundin e fragmentit? Pse?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi argumenton pëlqimet e tij për tekstin që lexon.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

## KLASA VIII

### “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” Ismail Kadare

#### *Fragment*

Dasma bëhej në një shtëpi në qendër të fshatit. Gjenerali nuk e priste që pamja t’i bënte përshtypje kaq të madhe. Ai u hutua aq shumë, sa në fillim, kur hyri nuk pa asgjë të qartë, por vetëm një grumbull ngjyrash lëvizëse e të gjalla sikur dikush t’i kishte rënë me një shuplakë të fortë syve dhe sytë t’i lëshonin xixa.

Pastaj gjenerali filloi të ndiqte me sy lëvizjet e shkathëta të këmbëve dhe përplasjen ritmike të thundrave në dysheme nën sundimin e dridhshëm të daulles, fëshfëritjen e fustanellave të bardha e pala-pala të burrave, krejt të bardha si dëbora, si dëbora e Alpeve ku ai kish kaluar, ngritjen e dollive me fraza të gjata e të ngatërruara që të përkthyer nuk kishin pothuajse farë kuptimi, këngët e ashpra të burrave që të kujtonin rrokullisjen e muzgjeve në pjerrësitë malore dhe këngët e zgjatura e të përmallshme grarishte që dukej sikur mbështeteshin në supet e mëdha të këngëve të burrave dhe ecnin bashkë kokulur përjetësisht.

Gjenerali vështronte përreth gjithçka dhe nuk mendonte dot asgjë. Vetëm pinte raki e buzëqeshte vazhdimisht, pa e ditur edhe vetë se kujt i buzëqeshte.

#### **Pyetja 1:**

Këngët e grave:

- A) janë në harmoni me bukuritë e natyrës shqiptare.
- B) janë të ashpra si pjerrësia e maleve tona.
- C) kanë të njëjtin ritëm dhe muzikalitet me këngët e burrave.
- D) plotësojnë dhe mbështeten te këngët e burrave.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare


**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

## Pyetja 2:

Duke u bazuar në fragment, tregoni dy argumente që mund të jepte ky lexues që të justifikonte mendimin e tij.



**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi argumenton mendimin e tij në lidhje me personazhet e tekstit letrar.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

## Pyetja 3:

Ç' ide ju krijon pranëvënia dasmë-gjeneral?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj.

Nxënësi interpreton tekstet dhe jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

#### **Pyetja 4:**

Cila është lidhja mes pjesës së parë dhe pjesës së dytë të fjalisë: “Gjenerali vështronte përreth gjithçka dhe nuk mendonte dot asgjë”?

Pjesa e dytë:

- A) e kundërshton pjesën e parë.
- B) e plotëson pjesën e parë.
- C) ilustron problemin e dhënë në pjesën e parë.
- D) shpreh shkakun e pjesës së parë.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton marrëdhëniet mes pjesëve në një fjali bashkërenditëse.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

#### **Pyetja 5:**

Gjeni kallëzuesin në fjalinë “Pastaj gjenerali filloi të ndiqte me sy lëvizjet e shkathëta të këmbëve dhe përplasjen ritmike të thundrave në dysheme nën sundimin e dridhshëm të daulles, fëshfëritjen e fustanellave të bardha e pala-pala të burrave, krejt të bardha si dëbora” dhe përcaktoni llojin e tij.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë dhe përvojën e tij.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

## **Pyetja 6:**

Gjeni një metaforë në paragrafin e dytë dhe tregoni funksionin e saj.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi gjen metaforën (figurat letrare) dhe tregon efektin ose funksionin e saj.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### **“Ca këshilla mbi artin e shkrimit” Faik Konica**

Kur qëlloni të shkruani gjësendi, qoftë një gjë e madhe a një artikull pesë-gjashtë radhësh, e para nevojë është të dini mirë ç’ doni të dëfteni. Se shumë herë këndojmë të shkruara, të cilat s’kanë as mendim, as qëllim dhe si mbarohen, një pyetje na vjen më buzë: “Mirë, po ç’ doli nga kjo?” Para se të zini të shkruani, pra, thuani vetes suaj: “Dale të mendohem mirë ç’ dua për të shkruar...”

Si të vendosni në mend ç’ keni për të thënë, kërkoni mënyrën qysh do ta thoni. Duhet në krye ca fjalë, hyrje, të shkurtra dhe për t’u pëlqyer që të kuptojë këndonjëtori “ku fle lepurit”, si thonë toskët dhe që të ëmbëlsohet e ta ketë ënda të këndojë më poshtë. Se po të jetë hyrja si një gërmadhë, shpejt-shpejt këndonjëtori kthen fletën.

Pas hyrjes, zini të shfaqni mendimin tuaj, jo përnjëherë, po dalëngadalë, thela-thela, që të qëllitet më lehtë, që të kuptohet më thellë. Togjet e fjalëve (a frazat) të mos jenë kurrë të veçanta, po të jenë të lidhura njëra me tjetrën; një togfjalësh duhet të pjellë një tjetër më poshtë që të hipnjë këndonjëtori si në një shkallë dhe kur t’i afronjë majës të jetë gati për të kuptuar prapone. Se po të hidhni pa vijë një copë mendim këtu, një copë mendim atje, do të bëhet një çorbë ku këndonjëtori s’ka për të kuptuar tjetër gjë, përveçëse shkronjëtori nuk di të japë kuptim.

Prapoja duhet me një mënyrë të ngjeshur e të fortë, të përsëritnjë në fare pak fjalë gjithë mendimet e mësipërme edhe të nxjerrë një fund, i cili është qëllimi i shkronjës.

Mbani mend dhe ca të tjera të nevojshme: Kur e thatë një gjë një herë të jetë e mbaruar, mos ma përsëritni më tutje me të tjera fjalë. Gjuha të jetë e qëruar, pa ato fjalë që na i kanë mbjellë magjitë e të huajve; të merret vesh lehtë; prandaj hiqni dorë nga togjtë letrash të gjata, të cilët duhet mjeshtri e madhe për t'i përdorur. Mësoni dhe mirë rregullat e gjuhës shqipe: mos thoni për tregim: “Fshati që u linda”; kjo mënyrë përdorje e fjalës që është turqisht dhe mjaft për të qeshur, në shqipe duhet thënë: “Fshati ku u linda” a “Fshati në të cilin u linda”.

Në fund, kur shkruani një gjë, këndojeni dhe ndreqeni shumë herë që të bjerë në vesh çdo tog letrash si një copë muzike.

### **Pyetja 7:**

Bazuar në tekstin e mësipërm, renditni tri këshilla që duhen ndjekur kur shkruajmë një tregim të shkurtër.

<b>Struktura e tregimit</b>	<b>Këshilla</b>
Hyrja	
Zhvillimi	
Mbyllja	

**Kompetenca:** Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi respekton strukturën e një pune me shkrim.

Nxënësi përdor informacionin e tekstit në situata të reja.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

### Pyetja 8:

Zëvendësojini fjalët e mëposhtme me variantin e tyre në gjuhën standarde shqipe.

Fjala në tekst	Fjala në gjuhën standarde
Dëfteni	
Shkronjëtori	
Prapoja	
Këndonjëtori	

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përdor gjuhën standarde shqipe gjatë komunikimit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me plotësim

**Pikëzimi:** 3 pikë

### Pyetja 9:

Plotësoni:

Sipas Konicës, më e rëndësishme kur nisim të shkruajmë, është\_\_\_\_\_.

**Kompetenca:** Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton qëllimin për punën me shkrim.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me plotësim

**Pikëzimi:** 1 pikë



**Pyetja 10:**

Nënvizoni kallëzuesit në fjalinë: “Pas hyrjes, zini të shfaqni mendimin tuaj, jo përnjëherë, po dalëngadalë, thela-thela, që të gëlltitet më lehtë” dhe përcaktoni llojin e tyre.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon kallëzuesin dhe përcakton llojin e tyre.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 4 pikë

## KLASA IX

### “Konica dhe qëllimi i jetës së tij” F. S. Noli

Konicën për herë të parë e kam pjekur më 1906. Atë ditë s’kam për ta harruar kurrë. Më shkroi nga Londra se do të mbërrinte në Boston i veshur me kostum shqiptar me qëllim që fotografia t’i botohej nëpër gazeta dhe kështu ta shfrytëzonte rastin për t’i trumbetuar botës çështjen kombëtare shqiptare që ishte dhe qëllimi i jetës së tij. Ndonëse deri më atëherë s’kisha parë fustanellë shqiptare, e merrja me mend se duhet të ngjasonte me fustanellën greke që nuk ndryshon shumë nga një fustan balerine. Habia ime ishte vërtet e madhe kur pashë se fëmijët e Bostonit mbetën të admiruar pas Konicës. Atëherë e kuptova se fustanella shqiptare nuk ngjasonte aspak me simotrën e saj greke. Ajo i afrohej më tepër fundit skocez dhe i shkonte shumë për shtat një burri të pashëm si Konica.

Por Konica nuk më habiti vetëm me veshjen e tij. S’po u besoja veshëve kur nisi të më ligjëronte për çfarëdo teme që të shkon ndërmend. Ishte njeri me kulturë të madhe. Gijom Apoliner, një shkrimtar francez që ishte mik i tij, e quante “enciklopedia që ecën”, dhe që “e fliste frëngjishten si francez i lindur”. Një tjetër shkrimtar francez Zhyl le Metre, ka shkruar për të “Ky i huaj ka shkruar kaq bukur gjuhën tonë”.

Tani të themi dy fjalë për vendin që zë Konica në historinë e Shqipërisë.

Si mysliman që ishte dhe si biri i një familjeje aristokrate nga Shqipëria e Jugut, Konica kishte të gjitha mundësitë të zinte një pozitë të lartë në Perandorinë Turke, ku bënte pjesë dhe Shqipëria që nga vdekja e Skënderbeut. E vërteta është se gjatë shekujve shumë shqiptarë kishin marrë ofiqe të larta në Perandorinë Turke. Për shembull në të ri të Konicës, veziri i madh apo kryeministri i Perandorisë Turke, Ferid Pasha, ishte shqiptar nga Vlora. Por Konicës nuk i pëlqente kjo karrierë. Misioni që i caktoi vetes ishte lufta për pavarësinë e Shqipërisë.

### Pyetja 1:

Qëllimi kryesor i autorit në këtë fragment është:

- A) të flasë për miqësinë me Konicën.
- B) të shpjegojë shijet artistike të Konicës.
- C) të vlerësojë Konicën si intelektual dhe si patriot.
- D) të vlerësojë kontributin e Konicës në letërsinë shqipe.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton qëllimin e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

### Pyetja 2:

Noli përdor fjalën *ligjëronte* dhe jo *fliste* për Konicën. Cila është arsyeja?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon gjuhën e figurshme të tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

### Pyetja 3:

Si e gjykoni veprimin e Konicës për të tërhequr vëmendjen e medias drejt çështjes kombëtare shqiptare? Po ju çfarë do të kishit bërë në vend të tij?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi gjykon idetë e tekstit.

Nxënësi lidh idetë e tekstit me jetën e tij.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Pyetja 4:**

Gjeni një fakt dhe një opinion për Konicën në tekstin e mësipërm. Ç’ funksion ka përdorimi i fakteve në tekst?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon faktet dhe opinionet në tekst.

Nxënësi analizon informacionin e tekstit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Esad Mekuli “Mbramja”**

Si tufa mëndafshi t’artë në të kaltërtën shami

si mes dy duersh t’bardha, dy kodra në borë-

flakëron perëndimi... Retë mbi krye prorë

ngasin nëpër qiell dhe zhduken n’hapsi.

... Dhe drita e mbrame shuhet mbi çdo sukë:

cipa e natës shtrihet mbi fushat e përhimë,

malet heshtin n'errësi si me qenë të ngrime,

si të humbet jeta- çdo gja u nxi, u zhduk.

N'ajri ndihen klithmat e natës që ra-

drujt pranë rrugës era i përkund...

ndërsa drita e bardh, e tretun dikun,

shigjeta të flakta mpreh errësinës me i ra.

Terri sundon botën. Katundet e shtrime

në mes të natës prehen n'lugin me andrrime.

### **Pyetja 5:**

Plotësoni: Motivi kryesor i kësaj poezie është \_\_\_\_\_.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton motivin në një poezi.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me plotësim

**Pikëzimi:** 1 pikë

### Pyetja 6:

Në vargjet: “*flakëron perëndimi... Retë mbi krye prorë/ ngasin nëpër qiell dhe zduken n’hapsi.*” metaforat janë:

- A) emra.
- B) folje.
- C) mbiemra.
- D) ndajfolje.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi përcakton klasat e fjalëve.

Nxënësi dallon figurat letrare (metaforën).

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

### Pyetja 7:

Tema e fjalës *perëndim* është:

- A) perëndi.
- B) perëndo.
- C) perëndim.
- D) perënduar.

**Kompetenca:** Përdorimi i drejtë i gjuhës

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi analizon fjalën sipas ndërtimit.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

### **Pyetja 8:**

Shënoni *e vërtetë/e gabuar* për pohimet e mëposhtme.

- a) Figura letrare që përftohet nga renditja e fjalëve që përshkruajnë peizazhin në mbrëmje është shkallëzim.
- b) Në fjalinë: “Katundet e shtrime në mes të natës prehen n’lugin me andrrime” është përdorur inversion.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon figurat letrare në një tekst letrar.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje *e vërtetë/e gabuar*.

**Pikëzimi:** 2 pikë

### **Pyetja 9:**

Përshkruani atmosferën që krijohet në dy vargjet e fundit të poezisë.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi diskuton rreth atmosferës që krijon poezia.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

### **Pyetja 10:**

Ç’ funksion kanë reticencat në këtë poezi?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi vlerëson gjuhën e autorit në një tekst.

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

# GJUHË SHQIPE

## KLASA X

### Pyetja 1:

Në qoftë se rrëfimtari vendos një raport bashkëbisedimi me lexuesin, teksti:

- A) ndërtohet nga perspektiva e vetës së parë.
- B) ndërtohet nga perspektiva e vetës së dytë.
- C) ndërtohet nga perspektiva e vetës së tretë.
- D) ndryshon vazhdimisht vetën e rrëfimit.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton karakteristikat gjuhësore të teksteve rrëfyese.

### Pyetja 2:

Si do të ndryshonte gjuha e një teksti përshkrues, nëse kalohet nga përshkrimi objektiv në përshkrim subjektiv?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi krahason përshkrimin objektiv me atë subjektiv.



### **Pyetja 3:**

Cili është funksioni i përdorimit të detajeve shqisore në një tekst përshkrues?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi interpreton ndërtimin gjuhësor të një teksti përshkrues.

### **Pyetja 4:**

Shënoni *e vërtetë/ e gabuar* në pohimet e mëposhtme.

- a) Në qoftë se një tekst informues do ta kthenim në tekst udhëzues (p.sh., në një rregullore).  
një nga ndryshimet që do t'i bënim foljes, është kthimi i foljes në mënyrën lidhore. \_\_\_\_\_
- b) Në qoftë se në një tekst mbizotëron toni sugjerues, atëherë ky tekst është argumentues. \_\_\_\_\_
- c) Nëse një tekst mbyllet me pyetje retorike, ka si qëllim të përfshijë lexuesin në diskutim. \_\_\_\_\_

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje *e vërtetë/ e gabuar*

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton funksionet, teknikat dhe karakteristikat stilistike dhe strukturore të teksteve jo letrare.

### Pyetja 5:

Lexoni me vëmendje tekstin: “Në Republikën e Shqipërisë kanë të drejtë për arsim të gjithë shtetasit pavarësisht nga mosha, përkatësia gjinore apo etnike. Pakicave kombëtare u sigurohet e drejta e arsimimit në gjuhën amtare deri në mbarimin e shkollës 9- vjeçare. Qytetarëve të rritur u krijohen kushte të përshtatshme për marrjen e arsimit të mesëm e të lartë edhe pa shpërblyer nga puna. Për t`u ardhur në ndihmë nxënësve, shteti organizon sistemin e bursave dhe të konvikteve. Fëmijët fillojnë arsimin e tyre kur mbushin moshën 6 vjeç, deri në ditën e fillimit të shkollës. Në vitin shkollor 2004- 2005 në Shqipëri çelën dyert 3350 shkolla publike (93%) dhe 244 jopublike (7%), ku 6337 mësues u dhanë mësim 43.895 nxënësve me kohë të plotë dhe 2260 me kohë të pjesshme.”

Gjeni një fakt dhe shtoni dy opinione në tekstin e mësipërm.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon faktet dhe opinionet.

### Pyetja 6:

Ju jeni duke shkruar një tekst me këshilla që duhen ndjekur gjatë një interviste pune. Listoni dy nga karakteristikat gjuhësore që duhen ndjekur gjatë shkrimit të këtyre këshillave.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton karakteristikat gjuhësore të teksteve udhëzuese.

### Pyetja 7:

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) oborri i një shkolle të madhe
- B) oborri i shtëpisë të madhe
- C) arritjet e një vajze së re
- D) kërkesat e punës të re

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përdor saktë nyjat para mbiemrave.

### Pyetja 8:

Gjeni kryefjalën në fjalinë “*Në krye të rrugës u dukën tre vetë.*” dhe tregoni me se është shprehur.

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përcakton gjymtyrët në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij.

### **Pyetja 9:**

Kur përshkruajmë një mjedis, në tekst mbizotëron:

- A) përdorimi i foljeve modale.
- B) përdorimi i foljeve në kohën e tashme.
- C) përdorimi i mbiemrave.
- D) përdorimi i ndajfoljeve dhe shprehjeve ndajfoljore.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi dallon karakteristikat gjuhësore të tekstit përshkruar.

### **Pyetja 10:**

Cili nga emrat e mëposhtëm nuk është emër i dygjinishëm?

- A) Fshat
- B) Krijim
- C) Natë
- D) Ujë

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi dallon emrat e dygjinishëm.

## **KLASA XI**

### **Pyetja 1:**

Letra personale është tekst i llojit:

- A) informues-paraqitës.
- B) rrëfyes.
- C) shpjegues.
- D) udhëzues.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi dallon llojet e tekstit joletrar.

### **Pyetja 2:**

Toni i një teksti udhëzues është zakonisht:

- A) i ashpër.
- B) i ftohtë dhe serioz.
- C) polemizues.
- D) sugjerues dhe këshillues.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi dallon veçoritë gjuhësore të një teksti udhëzues.

### **Pyetja 3:**

Nëse një fjali subjektive do ta kthejmë në fjali objektive, cilat janë dy ndryshimet kryesore gjuhësore që do të bëni?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon teknikat e rrëfimit dhe funksionet e tyre.

### **Pyetja 4:**

Cili është funksioni i përdorimit të mbiemrave në një tekst përshkrues?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon funksionet gjuhësore dhe stilistike të mjeteve të përshkrimit.

### **Pyetja 5:**

Nëse përshkruhet një veprim që ende nuk ka përfunduar, autori rrëfen në:

- A) kohën e tashme të mënyrës dëftore
- B) kohën e pakryer të mënyrës dëftore
- C) kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore
- D) kohën e ardhme të mënyrës dëftore

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon veçoritë gjuhësore dhe funksionet e foljeve.

### **Pyetja 6:**

Nëse një tekst argumentues mbyllet me një pyetje retorike, autori ka si qëllim:

- A) të përforcojë tezën.
- B) të përfshijë lexuesin emocionalisht.
- C) të përmbledhë kuptimin e paragrafëve.
- D) të shpjegojë më mirë tezën.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon veçoritë strukturore të tekstit argumentues.

### **Pyetja 7:**

Ju do të shkruani një reklamë për një produkt. Listoni dy teknika që do të përdorni për të bindur lexuesin.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon teknikat bindëse në një tekst argumentues

### **Pyetja 8:**

Çfarë do të ndryshonte në një tekst nëse perspektiva e rrëfimit ndryshon nga veta e tretë njëjës në vetën e dytë shumës?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon funksionet gjuhësore dhe stilistike të mjeteve të rrëfimit.



### Pyetja 9:

Parafjalët: *me, mbi, nën, nëpër*, janë të rasës:

- A) emërore.
- B) gjinore.
- C) kallëzore.
- D) rrjedhore.

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon parafjalën dhe llojet e saj

### Pyetja 10:

Përcaktoni klasën e fjalës së nënvizuar: “Afër shtëpisë sime është hapur një librari”.  
Argumentoni përgjigjen tuaj.

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar.

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi krahason parafjalën dhe ndajfoljen.

## KLASA XII

### Pyetja 1:

Plotësoni nga një tipar të gjuhës së:

- A) stilit të letërsisë artistike\_\_\_\_\_
- B) stilit tekniko-shkencor\_\_\_\_\_
- C) stilit juridiko –administrativ\_\_\_\_\_

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me plotësim

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi liston tiparet e stileve të gjuhës shqipe.

### Pyetja 2:

Shënoni me po ose jo.

Në ligjërimin libror, norma gjuhësore ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera .

PO

JO

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me *po/jo*

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon veçoritë kryesore të ligjërimeve.

### **Pyetja 3:**

Shënoni me po ose jo.

Të gjitha fjalitë që futen ndërmjet një fjalie tjetër, quhen fjali të ndërmjetme.

PO

JO

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me *po/jo*

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon fjalinë e ndërmjetme.

### **Pyetja 4:**

Në një paragraf argumentues dalloni një fakt dhe një opinion. Shpjegoni arsyet e përdorimit të tyre nga autori.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 4 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon karakteristikat gjuhësore të tekstit argumentues.

### **Pyetja 5:**

Prapashtesa është:

- A) fjalëformuese.
- B) trajtëformuese dhe fjalëformuese.
- C) trajtëformuese.

**Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon mjetet fjalëformuese të gjuhës shqipe.

### **Pyetja 6:**

Shkruani një fjali si tezë për një artikull mbi diversitetin kulturor.

**Kompetenca:** Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi përzgjedh dhe organizon opinione për një shkrim argumentues.

### **Pyetja 7:**

Interpretoni përzgjedhjen stilistike të autorit, në një tekst të rrëfyer në vetën e parë. Çfarë efekti ka ky lloj rrëfimi?

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon karakteristikat stilistikore dhe gjuhësore të një teksti rrëfyes.

**Pyetja 8:**

Nëse një tekst ndërtohet sipas organizimit kronologjik, teknika që përjashtohet është:

- A) krahasim-kontrasti.
- B) renditja logjike.
- C) retrospektiva.
- D) shkak-pasoja.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon karakteristikat strukturore të një teksti

**Pyetja 9:**

Cila fjali i takon modelit krahasim-kontrast?

- A) Jeta e fshatit është jetë e qetë dhe të jep mundësinë të udhëtosh nëpër qytete të ndryshme.
- B) Mundësitë për jetë argëtuese ekzistojnë dhe në fshat.
- C) Ndërsa jeta e qytetit sjell shumë mundësi sociale, jeta e fshatit siguron më të mirën e dy mjediseve.
- D) Qytetet kanë kinema, teatro, stadione dhe plot mundësi aktivitësh.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon karakteristikat strukturore të fjalive.

**Pyetja 10:**

Për të shkruar një fjalim bindës, është më e rëndësishme:

- A) analiza e audiencës.
- B) gjetja e argumentit.
- C) opinioni personal i autorit.
- D) përcaktimi i tezës.

**Kompetenca:** Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon karakteristikat e tekstit argumentues-bindës.

# LETËRSI

## KLASA X

### Pyetja 1:

Dialogu është tipari dallues i një vepre:

- A) dramatike.
- B) epike.
- C) epiko-lirike.
- D) lirike.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënimit:** Nxënësi dallon karakteristikat e gjinive letrare.

### Pyetja 2:

Kur poezia shkruhet me varg të bardhë, atëherë mungon:

- A) numri i njëjtë i rrokjeve në vargje.
- B) rima e brendshme.
- C) rima fundore.
- D) ritmi.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënimit:** Nxënësi dallon karakteristikat metrike të poezisë.

### **Pyetja 3:**

Cila është marrëdhënia kuptimore mes fjalëve “po trandet e po dridhet”, në skenën e ndëshkimit të Prometeut? Cila figurë letrare përftohet nga ky përdorim?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon mjetet stilistike dhe funksionet e tyre.

### **Pyetja 4:**

Argumentoni, nëpërmjet dy arsyeve pse Prometeu është një hero tragjik?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon personazhin dhe mesazhin e veprës.



### Pyetja 5:

Don Kishoti dhe Sanço Pança kanë të përbashkët:

- A) dëshirën për aventura.
- B) idealin e lirisë dhe të barazisë.
- C) shkëputjen nga realiteti.
- D) shpirtin praktik.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi krahason dhe analizon personazhet.

### Pyetja 6:

A mund të përshkruani një rast “donkishotizmi” në ditët e sotme?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e hapur

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon personazhin dhe mesazhin e veprës.

Nxënësi lidh idetë e veprës me jetën e tij.

### Pyetja 7:

Plotësoni:

Figura stilistike që është përdorur në vargun hyrës “*O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë*” të poemës “Bagëti e bujqësi”, është \_\_\_\_\_.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me plotësim

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon përdorimin e apostrofës.

### Pyetja 8:

Si i kuptoni fjalët e Hamletit: “Njeriu s’ më gëzon...” në fragmentin ku shfaqet kriza e idealeve humaniste?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi interpreton idetë e dhëna të tekst.

### **Pyetja 9:**

Argumentoni nëpërmjet shembujve pse Hamleti konsiderohet si njeriu universal (njeriu antik, mesjetar dhe modern)?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e hapur

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon dhe gjykon personazhin dhe mesazhin e veprës

### **Pyetja 10:**

Ofelia konsiderohet si heroinë tragjike, sepse:

- A) e kupton dashurinë si ndjenjë hyjnore.
- B) jetoj në kohën dhe vendin e gabuar.
- C) mashtrohet nga Hamleti kur ai shtiret si i çmendur.
- D) nuk është në gjendje të kuptojë ndryshimin e Hamletit.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi vlerëson personazhin dhe tiparet psikologjike të saj.

## KLASA XI

### Pyetja 1:

Poema “Bukuria” e Naim Frashërit i kushtohet:

- A) dashurisë konkrete të poetit.
- B) dashurisë si mishërim i të bukurës.
- C) të bukurës në natyrë.
- D) të Bukurës si koncept estetik.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon tiparet kryesore të lirikës erotike të N. Frashërit.

### Pyetja 2:

Identifikoni dy tipare tipike të lirikës erotike të Naim Frashërit në një fragment të poemës “Bukuria”.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi interpreton nëpërmjet shembujve tiparet e lirikës erotike të Naimit.

### Pyetja 3:

Dalloni një figurë të intonacionit poetik në këngën V të poemës “Këngët e Milosaos” dhe shpjegoni funksionin e këtij përdorimi.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon funksionet stilistike të mjeteve të rrëfimit dhe figuracionit letrar.

### Pyetja 4:

Ndjenjat e Milosaos në këngën V janë të dyzuara në:

- A) butësi dhe ëmbëlsi.
- B) dëshpëruese deri në pesimizëm.
- C) plot shqetësim dhe ankth.
- D) të kundërta me njëra-tjetrën.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon dhe interpreton psikologjinë e personazhit.

### **Pyetja 5:**

Në letërsinë realiste, tema kryesore e romaneve ishte:

- A) filozofike.
- B) historike.
- C) politike.
- D) sociale.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon tiparet kryesore të letërsisë realiste.

### **Pyetja 6:**

Përshkruani personalitetin e Ema Bovarisë, duke e gjykuar atë në kohë dhe në hapësirë.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e hapur

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon dhe vlerëson personazhin dhe mesazhet e autorit.

### **Pyetja 7:**

Pse autori, gjatë çasteve të fundit të jetës së Emës, përshkruan këngën e të verbrit?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon teknikat e rrëfimit në funksion të idesë.

### **Pyetja 8:**

Romani “Vëllezërit Karamazovë” pasqyron:

- A) historinë e familjes Karamazov.
- B) jetën e njeriut të zakonshëm, viktimë e fatit, por i lidhur fort me jetën.
- C) mekanizmat që mbajnë në këmbë një sistem të kalbur shoqëror.
- D) tragjedinë e njerëzve të thjeshtë në Rusinë e shekullit XIX.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi dallon temën dhe motivet kryesore të romanit.

### **Pyetja 9:**

Thelbi i poezisë simboliste të Bodlerit përmbledhet në fjalët:

- A) Arti është virtyt.
- B) Arti është frymëzim hyjnor.
- C) Arti është i gjatë, jeta është e shkurtër.
- D) Arti është vetëm imagjinatë.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi dallon dhe analizon veçoritë kryesore të simbolizmit.

### **Pyetja 10:**

Në poezinë “Himn i Bukurisë”, e bukura merr pamje të ndryshme. Identifikoni dhe interpretoni një të një prej tyre.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi analizon konceptin estetik të poezisë së Bodlerit.



## KLASA XII

### Pyetja 1:

Ndaj kujt drejtohen akuzat e Kafkës në veprën e tij?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi analizon dhe gjykon qëndrimin e Kafkës ndaj sistemit shoqëror.

### Pyetja 2:

Cilat janë dy arsyt kryesore të shndërrimit të Gregorit në novelën “Metamorfoza”?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënës:** Nxënësi analizon dhe interpreton mesazhin simbolik të veprës.

### **Pyetja 3:**

Sipas Kamysë, aty ku ka absurd, lind:

- A) kotësia.
- B) pakënaqësia.
- C) revolta.
- D) zhgënjimi.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi zbulon thelbin e letërsisë së Kamysë .

### **Pyetja 4:**

Në fragmentin e vrasjes së arabit, zbuloni në tekst mjetet stilistike që përcaktojnë raportin e Mersoit me diellin.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve stilistike në fragment.

### **Pyetja 5:**

Zbuloni dy nga risitë kryesore të poezisë së Lasgush Poradecit në poezinë “Zemra e Liqerit”.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi shpjegon risitë moderne të lirikës së Poradecit.

### **Pyetja 6:**

Përshkruani nëpërmjet detajeve atmosferën në fund të poezisë “Vdekja e Nositit”. Cila gjendje mbizotëron, pesimizmi apo optimizmi?

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 4 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon dhe interpreton kuptimet simbolike të poezisë

### **Pyetja 7:**

Në novelën “Studenti në shtëpi”, zbuloni kundërvënien midis botës mashkullore dhe femërore duke u bazuar në trajtimin e figurës së nënës dhe të Ages.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare  
Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi diskuton mbi pabarazinë shoqërore dhe analizon mënyrën si e sjell Migjeni në vepër.

### **Pyetja 8:**

Zbuloni në fragment një rast të përdorimit të ironisë tipike të Migjenit dhe analizoni funksionin e këtij përdorimi.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare  
Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 2 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon veçoritë e stilit të autorit dhe funksionet stilistikore të figuracionit.

### Pyetja 9:

Shiu, në poezinë “Lirikë me shi” të A. Shkrelit është:

- A) metaforë e dhimbjes për Kosovën.
- B) simbol i dhimbjes për Kosovën.
- C) simbol i pastrimit shpirtëror.
- D) simbol i trishtimit.

**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje me alternativa

**Pikëzimi:** 1 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi shpjegon simbolin kryesor të poezisë së Shkrelit.

### Pyetja 10:

Interpretoni kuptimin e vargut “As bora nuk është e bardhë në këtë muzg”, të poezisë së M. Camaj. Cila është figura letrare që krijon përfytyrimin e atmosferës shpirtërore të poetit?


**Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike

**Lloji i pyetjes:** Pyetje e strukturuar

**Pikëzimi:** 3 pikë

**Rezultati i të nxënit:** Nxënësi analizon funksionin stilistik të figuracionit dhe gjykon mbi kuptimet e dyfishta të vargut.



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)**

**[sekretaria@ascap.edu.al](mailto:sekretaria@ascap.edu.al)**

